

## **Rregullat e fushatës “Fast Track Ndërkombëtar”**

### **Përkufizimet dhe interpretimi i tyre**

**Fast Track** nënkupton një shërbim të veçantë që lejon një person të kalojë të gjitha procedurat në aeroport, në kohën minimale dhe me rehati maksimale, pa radhë të gjata.

**Kodi QR** nënkupton një kod të posaçëm grafik për marrjen e shërbimit, i cili i jepet në chatbot pjesëmarrësit në fushatë, sipas kushteve të këtyre rregullave.

**Aeroport** nënkupton Aeroportin e Stambollit (IST), Turqi, Aeroportin Ndërkombëtar të Larnakës (LCA) Republika e Qipros; Milano (MXP) Itali, Aeroportin e Barcelonës (BCN), Spanjë dhe aeroporte të tjera, një listë gjithëpërfshirëse e të cilave është e disponueshme në chatbot.

**Fushatë** nënkupton një fushatë promovuese “Fast Track Ndërkombëtar”.

**Bankë** nënkupton një person juridik i cili, bazuar në licencën përkatëse bankare, ka të drejtën ekskluzive për të ofruar shërbime bankare në territorin përkatës të Ukrainës, Gjeorgjisë ose Republikës së Azerbajxhanit, Republikës së Bjellorusisë, Republikës së Taxhikistanit, Republikës së Uzbekistanit, Republikës së Armenisë, Republikës së Kazakistanit, Republikës së Moldavisë, Republikës Kirgize (Kirgizistani), Republikës së Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Republikës së Kosovës, Republikës së Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi ose Republikës së Serbisë.

**Pajisje verifikimi** nënkupton një pajisje teknike të posaçme në aeroport që lejon leximin e kodit QR për ofrimin e shërbimit për anëtarin e fushatës, sipas kushteve të këtyre rregullave.

**Klient** nënkupton Shoqatën Ndërkombëtare të Shërbimit Visa, me vendndodhje në SHBA, CA 94404 – 2775, Foster City, Bulevardi Metro Center, 900.

**Kartë** nënkupton kartat e pagesës Visa Platinum, Visa Signature, kartat e biznesit Visa Platinum, Visa Signature dhe Visa Infinite të lëshuara nga bankat që i japin të drejtë pjesëmarrësit në fushatë për të marrë pjesë në fushatë.

**Messenger** nënkupton aplikacion celular për mesazhe të shpejta dhe video, duke përfshirë Viber, Telegram.

**Organizator** nënkupton INFOCUS LLC kodi i identifikimit të personit juridik: 36563986, me vendndodhje në Ukrainë, 03150, Kiev, Dilova Street 2, letter B, roon 188 letter A,

**Partner** nënkupton RENOVATIO LLS kodi i identifikimit të personit juridik: 38876589, me vendndodhje në Ukrainë, 61099, Kharkiv, 11-A Yenakiivska Street.

**Shërbim** nënkupton shërbimet në kategorinë Fast-Track (me mbërritje dhe nisje) që u ofrohet anëtarëve të fushatës në aeroport. Një shërbim i tillë është një dhuratë për pjesëmarrësin e promovimit.

**Rregulla** nënkupton këto rregulla të fushatës.

**Afati i vlefshmërisë** nënkupton periudhën nga 00:00:01 i datës 09.07.2021 deri më 23:59:59 të datës 30.09.2024.

**Pjesëmarrës të fushatës** nënkupton individë, mbajtës të kartave, të cilët kanë të drejtë të marrin pjesë në fushatë sipas dispozitave të këtyre rregullave. Shërbimi është i njëjtë për të gjithë pjesëmarrësit. Në këtë rast, ndryshimi i vetëm është se cilat karta kanë mbajtësit e tyre.

**Chatbot** nënkupton chatbot-in dhe “Visa Concierge”, të cilat gjenden në link-un: [https://mssg.me/concierge\\_service](https://mssg.me/concierge_service), të përfshira në Messenger.

## **1. Procedura për pjesëmarrjen në fushatë nga anëtarët e fushatës**

**1.1.** Për qëllim të pjesëmarrjes në fushatë, një person që dëshiron të marrë pjesë në fushatë dhe të bëhet anëtar i fushatës do të kryejë veprimet e mëposhtme gjatë afatit të vlefshmërisë së fushatës:

**1.1.1.** të jetë mbajtës i vlefshëm i kartës;

**1.1.2.** të regjistrohet vetë ose të jetë i regjistruar në chatbot sipas mekanikës së regjistrimit të brendshëm të përfshirë në chatbot;

**1.1.3.** të hapë chatbot, shkojë tek menyuja "Visa Travel" dhe klikojë "Fast Track Ndërkombëtar";

**1.1.4.** Të njihet me të dhënat rreth fushatës dhe këtyre rregullave duke klikuar butonin "Fast Track Ndërkombëtar";

**1.1.5.** Të kontrollojë disponueshmërinë e shërbimit dhe të zgjedhë vendin dhe aeroportin;

**1.1.6.** Të klikojë butonin "merr një kupon";

**1.1.7.** Te zgjedhë një nga llojet e ofruara të fluturimeve: nisje kombëtare, nisje apo mbërritje ndërkombëtare

**1.1.8.** Të japë numrin, datën, orën e nisjes së fluturimit, emrin dhe mbiemrin (sipas biletës), numrin e telefonit dhe adresën e email-it, në chatbot.

**1.2.** Në rast të kryerjes me sukses të veprimeve të përcaktuara në pikat 1.1.1.-1.1.8. të këtyre rregullave, personi do të bëhet anëtar i fushatës dhe do të marrë një skedar me kod QR në chatbot.

**1.3.** Këto rregulla do të jenë dokumenti kryesor në marrëdhëniet zyrtare ndërmjet anëtarit të fushatës dhe organizatorit/klientit/partnerit. Anëtar i fushatës do të pranojë dispozitat e këtyre rregullave duke kryer në mënyrë të njëpasnjëshme veprimet e specifikuar në pikat 1.1.1.-1.1.8. të këtyre rregullave.

**1.4.** Pranimi nga anëtar i fushatës do të bëhet vullnetarisht dhe do të materializojë përfundimin e një marrëveshjeje me shkrim mbi kushtet e këtyre rregullave.

**1.5.** Pranimi i pjesshëm i rregullave nuk do të pranohet.

**1.6.** Karta do të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e vlefshmërisë së biletës ajrore.

## **2. Veçoritë e aplikimit të kodit QR**

**2.1.** Ju mund ta porosisni shërbimin në çdo datë gjatë vitit. Kodi QR është i vlefshëm në datën e porositjes së shërbimit, por përdor fluturimet e specifikuar në pikat 1.1.7. dhe 1.1.8. të rregullave.

**2.2.** Kodi QR do t'u jepet anëtarëve të fushatës, duke iu nënshtruar kufizimeve të mëposhtme:

**2.2.1.** për pjesëmarrësit në fushatë që janë mbajtës të kartës Visa Platinum, do të sigurohen jo më shumë se 2 (dy) kode QR brenda afatit të vlefshmërisë së fushatës;

**2.2.2.** për pjesëmarrësit në fushatë që janë mbajtës të kartës Visa Signature, do të sigurohen jo më shumë se 10 (dhjetë) kode QR brenda afatit të vlefshmërisë së fushatës;

**2.2.3.** për pjesëmarrësit në fushatë që janë mbajtës të kartës Visa Infinite, kodet QR do të sigurohen në shumën e kërkuar nga pjesëmarrësi i fushatës, mbajtës i kartës Visa Infinite brenda afatit të vlefshmërisë së fushatës.

**2.3.** Kodi QR mund të përdoret ekskluzivisht nga pjesëmarrësi i fushatës për qëllimet e tij/saj dhe nuk mund t'u transferohet palëve të treta.

**2.4.** Kodi QR i përdorur brenda afatit të vlefshmërisë së fushatës nuk do të shtyhet ose grumbullohet, nuk do të shtohet ose t'i nënshtrohet asnjë kompensimi financiar ose kompensimi tjetër.

**2.5.** Skedari i kodit QR ka një funksion "butoni i përgjigjes së shpejtë" për kontaktin me mbështetjen teknike të partnerit, në rast të ndonjë problemi me kodin QR.

### **3. Përgjegjësia e Palëve**

**3.1.** Pjesëmarrësi në fushatë do të jetë përgjegjës sipas legjislacionit në fuqi për saktësinë e të dhënave të siguruara dhe të drejtën e përdorimit të kartës.

**3.2.** Pagesa e taksave, tarifave dhe pagesave të detyrueshme bëhet nga personi ndaj të cilit ngarkohen detyrimet përkatëse nga dispozitat e legjislacionit aktual.

**3.3.** Klienti/partneri/organizatori nuk do të jetë përgjegjës për pamundësinë e anëtarit të fushatës për të përdorur kodin QR për arsye jashtë kontrollit të tyre, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: shkaqe të prishjes së pajisjes së verifikimit, anulimit, shtyrjes ose vonesave të fluturimit, ndryshimeve në funksionimin e aeroportit, shkeljeve nga ana e anëtarit të fushatës të dispozitave të legjislacionit aktual etj...

### **4. Përpunimi i të dhënave personale**

**4.1.** Në kuadër të fushatës, pjesëmarrësi në fushatë do t'i sigurojë organizatorit të dhënat personale të mëposhtme, në zbatim të marrëveshjes së lidhur sipas këtyre rregullave, për arsye individuale në përpunimin e të dhënave personale të tij/saj: mbiemrin, emrin dhe emrin e babait në anglisht, numrin e telefonit dhe adresën e email-it. Këto rregulla të përpunimit të të dhënave do të jenë pjesë e rregullave të përpunimit të të dhënave të përfshira në chatbot.

**4.2.** Të dhënat personale të përcaktuara në pikën 4.1. do të përpunohen gjatë afatit të vlefshmërisë së fushatës për të ushtruar të drejtën e anëtarit të fushatës për të marrë pjesë në fushatë. Të dhëna të tilla personale do të mbliidhen, përpunohen, transmetohen (në server të huaj të organizatorit dhe partnerit) me qëllim përmbushjen e kushteve të këtyre rregullave. Organizatori do të jetë pronari dhe administratori i këtyre të dhënave personale. Partneri do të ketë politikën e tij/saj për trajtimin e të dhënave personale, por në çdo rast, këto të dhëna nuk mund të përpunohen në kundërshtim me këto rregulla. Pjesëmarrësi në fushatë mund të njihet me politikën e përpunimit të të dhënave personale të partnerit në faqen e mëposhtme: <https://highpass.aero/Home/PrivacyPolicy>

**4.3.** Gjatë kryerjes së veprimeve të përcaktuara në pikën 1.1. të rregullave, anëtari i fushatës do të pajtohet me rendin e vendosur të përpunimit të të dhënave të tij personale dhe do të konfirmojë se është njohur me të gjitha të drejtat që i janë dhënë nga legjislacioni aktual.

### **5. Të tjera**

**5.1.** Organizatori ka të drejtë të përfshijë palë të treta për të përmbushur detyrimet sipas këtyre rregullave të fushatës.

**5.2.** Nëse lind situata që lejon interpretim të paqartë të këtyre rregullave, çdo mosmarrëveshje dhe/ose çështje që nuk rregullohet nga këto rregulla, organizatori/klienti i fushatës do të rezervojë të drejtën të zgjidhë çështje të tilla në mënyrë të pavarur. Një vendim i tillë i organizatorit/klientit të fushatës do të jetë përfundimtar dhe nuk i nënshtrohet ankesave.

**5.3.** Afati i vlefshmërisë së fushatës mund të ndryshohet ose fushata mund të ndërpritet para kohe me miratimin reciprok të klientit dhe organizatorit. Ndryshimi i afatit të vlefshmërisë së fushatës ose

përfundimi i para afatit i saj do të jetë efektiv vetëm në rast të publikimit të tyre në chatbot.

**5.4.** Këto rregulla dhe ndryshimet në to do të postohen për referencë në chatbot.

**5.5.** Organizatori do të rezervojë të drejtën për të ndryshuar këto rregulla brenda afatit të vlefshmërisë së fushatës.